



UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË

MIRATOHET

MINISTRI

MYQEREM TAJAJ

STATUTI

I

**SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE PRIVATE
“UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË”**

Tiranë, janar 2013

Kreu I

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Shkolla e lartë Universitare Private "Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë", për më tej UMSH, është krijuar Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 177, datë 19.02.2009 "Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit "Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë" dhe ushtron aktivitetet në bazë të Ligjit 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

UMSH është një institucion i arsimit të lartë privat (jopublik), është laik dhe me karakter jopolitik.

Neni 2

UMSH është në pronësi të subjektit juridik Qendra Mesdheu shpk, e cila ka fituar personalitet juridik me Vendim Nr. 411, datë 06.07.2007, të Gjykatës së Rrethit gjyqësor Tiranë.

Ky statut përcakton organizimin dhe veprimtarinë e UMSH si institucion privat (jopublik) i arsimit të lartë, në fushën e mësimdhënies e atë të kërkimit shkencor, në financimin e kësaj veprimtarie etj, lidhur me këtë proces. Qendra Mesdheu merr cdo vendim lidhur me politikën e drejtimit dhe të organizimit të studimeve në institucion, siguron që ato të jene në respektim të të akteve ligjore dhe nënligjore për arsimin e lartë në republikë e shqipërisë dhe në harmonizim me standardet e hapësirës europiane dhe ato shtetërore . Qendra Mesdheu merr në konsideratë dhe do të vlerësojë të gjitha propozimet që do të vijnë nga struktura akademike e institucionit, por do të jetë ajo që do të vendosë për çështje të politikave të zhvillimit dhe të zgjerimit institucional të UMSH.

Neni 3

UMSH është një institucion i arsimit të lartë që kryen veprimtari mësimore dhe kërkimore, ai ndërthur në mënyrë të integruar dhe në përputhje me planet mësimore, mësimdhënien me kërkimin shkencor, të organizuar ose të pavarur. Këtë veprimtari e kryen në përputhje dhe në zbatim të Ligjit Nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe akteve nënligjore të tij, në të njëjtën kohë, kryen edhe veprimtari të pavarur ekonomike që rregullohet nga legjislacioni tregtar në fuqi.

Neni 4

UMSH ka për mision të kontribuojë në zhvillimin e Arsimit të Lartë, arsimimin cilësor universitar në fushën e shkencave politike, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të diplomacisë dhe në shkencat ekonomike.

UMSH ka për qëllim:

- a) të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor
- b) të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj
- c) të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal

- d) të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë
- e) Të ofrojë programe studimi në përputhje me kërkesat dhe nevojat e tregut
- f) Të përgatisë specialistë të lartë në fushat në të cilat UMSH është licensuar, më formim të përgjithshëm dhe/ose të profilizuar
- g) Të kryejë studime ne dhe kërkime në fushat përkatëse
- h) Të ofrojë arsimim specializues si dhe kualifikim të vazhdueshëm për studentët e tij, si dhe për studentë ose individë të tjerë të interesuar në këto fusha.
- i) Të kryejë/të mbështesë botime të teksteve mësimore, të materialeve të tjera ndihmëse të procesit mësimor si dhe cdo botim tjetër në interes të institucionit.

Neni 5

- a) UMSH gëzon autonominë institucionale dhe lirinë akademike në procesin mësimor, në kërkimin shkencor dhe në lirinë e krijimit në përputhje me Ligjin Nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- b) Liria akademike nënkupton me mësimdhënien, respektimin e shumëllojshmërisë së opinionëve, ideve, metodave dhe garantimin e zhvillimit të lirë, kritik e krijues të mësimdhënies e kërkimit shkencor
- c) Liria akademike nënkupton që personeli akademik është i lirë prej ndikimeve dhe ndërhyrjeve ose faktorëve të tjerë që ndikojnë në aktivitetin e UMSH dhe është në përputhje me planet dhe programet mësimore të miratuara.

Neni 6

UMSH ka të drejtë:

- a) Të zgjedhë lirisht strukturën institucionale të UMSH, duke ofruar programe studimi të cikleve të ndryshme, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë.
- b) Të miratojë planet, programet mësimore dhe të kërkimit shkencor, tekste në përdorim të studentëve si dhe literaturën përkatëse.
- c) Të caktojë autoritetet dhe organet e veta drejtuese sipas Statutit deri në nivel departamenti
- d) Të përzgjedhe personelin akademik, personelin ndihmës akademik dhe atë administrativ.
- e) Të përcaktojë, nëse e vlerëson të arsyeshme, kritere veçanta për cdo program studimi, si kusht për pranimin e studentëve në to, për cdo vit akademik.
- f) Të anëtarësohet në shoqata e organizata kombëtare e ndërkombëtare të arsimit të lartë publik apo privat.
- g) Të krijojë lidhje bashkëpunimi institucione të arsimit të lartë, shoqëri biznesi ose organizata të tjera; vendase ose të huaja, publike ose private;
- h) Të përcaktojë procedurat dhe kriteret për dhënien e bursave të studimit
- i) Të bashkëpunojë me partnerë vendas dhe të huaj dhe të pranojë donacione nga fondacione vendase e të huaja që ndihmojnë zhvillimin e arsimit të lartë.
- j) Të ngrejë sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë
- k) Të përdorë pasuritë e paluajtshme dhe pasuritë që ai zotëron ose që ka në qiramarrje për qëllime arsimimi ose që lidhen me të
- l) Të zotërojë cdo lloj pasurie tjetër sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 7

Të gjitha mjediset e UMSH gëzojnë paprekshmërinë që Ligji 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i garanton institucioneve të arsimit të lartë. Ndërhyrja e organeve të rendit publik në mjediset akademike të UMSH behet vetëm në rastet e nevojës ekstreme etj., dhe me kërkesën dhe /ose lejen e Rektorit, Administratorit. Vetëm në rastet e kryerjes së një krimi flagrant dhe në rastet e një fatkeqësie natyrore, organet e rendit publik ndërhyjnë edhe pa lejen e tyre.

Neni 8

UMSH detyrohet:

- a) Të zhvillojë procesin mësimor si dhe atë kërkimor e shkencor sipas standardeve shtetërore të cilësisë dhe në përputhje me normat dhe standardet e hapësirës europiane të studimeve
- b) Të respektojë angazhimet e ndërmarra prej tij që burojnë nga kontratat me studentët dhe pedagogët
- c) Të raportojë në MASH për veprimtarinë e tij mësimore –shkencore sipas parashikimeve ligjore
- d) Të kryejë procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë dhe të paraqesë kërkesën për akreditimin e parë të programeve të studimit para lëshimit të diplomave të para
- e) T'i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik të programeve të studimit dhe atij institucional
- f) Të bëjë publike programet e studimit që ofron sipas cikleve
- g) Të bëjë të njohur publikisht nëse programet e studimit janë të akredituara në respektim të afateve kohore të përcaktuara nga ligji.

Neni 9

UMSH ka detyrimin për sigurimin e cilësisë së diplomave/programeve të studimit që ai ofron në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Sigurimi i brendshëm cilësisë kryhet nga vetë UMSH, nëpërmjet Njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë.

Sigurimi i jashtëm i cilësisë kryhet nga Agjencia Publike e Akreditimit të arsimit të Lartë, me kërkesë të Rektorit të institucionit pas përfundimit të raportit të vlerësimit të brendshëm. Rektori i UMSH vendos të kryejë vlerësimin e jashtëm të cilësisë për programin/et e studimit ose të institucionit edhe nga Agjenci të tjera akreditimit, antare të ENQA-s ose të Rregjistrit European të Sigurimit të Cilësisë.

Kreu II

ORGANIZIMI I UMSH

Neni 10

UMSH përbehen nga njësiti organizative: kryesore, bazë dhe ndihmëse si dhe njësi administrative.

1. Njësi kryesore në UMSH janë fakultetet:
 - Fakulteti i Shkencave Ekonomike
 - Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike
 - Cdo fakultet apo institut tjetër që mund të krijohet në të ardhmen.
2. Departamentet dhe qendrat e kërkimit dhe të zhvillimit konsiderohen njësi bazë. Në UMSH cdo fakultet përbëhet nga së paku 2 departamente dhe një qendër.

Për Fakultetin e Shkencave Ekonomike, njësiti bazë janë:

- i. Departamenti i Financë Bankë dhe Kontabilitet
- ii. Departamenti i Ekonomisë

Për Fakultetin e Shkencave Juridike dhe Politike

- i. Departamenti i së Drejtës dhe Administratës
- ii. Departamenti i Shkencës Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare

3. Laboratorët, biblioteka dhe njësi të tjera që shërbejnë për të realizuar studime dhe shërbime në kuadër të formimit, konsiderohen njësi ndihmëse.
4. Njësiti kryesore, bazë dhe ato ndihmëse në UMSH (i licensuar me VKM Nr177, datë19.02,2009), hapen pas miratimit të tyre në Senatin Akademik dhe. Programet e studimit që do të ofrohen në fakultete organizohen dhe funksionojnë pas miratimit dhe lejes së Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.
5. Në UMSH mund të krijohen në të ardhmen edhe njësiti e tjera kryesore, bazë ose ndihmëse, të cilat do të organizohen sipas parimeve të strukturës përkatëse, të shprehura në këtë statut.

Neni 11

Fakulteti është njësi kryesore, që bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore-kërkimore, të përafërta ose të ndërthurura.

Fakulteti ofron programe të studimeve të llojeve dhe niveleve të ndryshme, në përfundim të të cilave përfitohet diplomë.

Neni 12

1. Departamenti është njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar liritë akademike të personelit

akademik. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të departamentit përcaktohen në rregulloren e UMSH.

2. Strukturë të ngjashme me departamentin kanë edhe qendrat e kërkimit dhe zhvillimit, të cilat kryejnë veprimtari kërkimore shkencore dhe zhvillimi, si dhe marrin pjesë në zhvillimin e programeve të studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, duke harmonizuar veprimtarinë e tyre edhe me departamentet përkatëse sipas fushave të kërkimit. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të qendrave përcaktohen në rregulloren e UMSH.

Neni 13

Njësitë ndihmëse kontribuojnë , së bashku me njësitë kryesore dhe bazë , në zhvillimin procesit akademik, kërkimor shkencor. UMSH ka këto njësi ndihmëse:

1. Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe e zhvillimit të curriculave
2. Biblioteka
3. Laboratori i teknologjisë së informacionit
4. Cdo njësi ndihmëse që mund të krijohet në të ardhmen

Neni 14

Njësitë e tjera administrative:

1. Sekretaria mësimore dhe pranimi i studentëve të rinj
2. Zyra e financës
3. Zyra e marrëdhënieve me Jashtë
4. Zyra e burimeve njerezore dhe rekrutimi.
5. Zyra e Këshillimit të studentëve dhe e karrierës
6. Cdo njësi administrative që mund të krijohet në të ardhmen

Kreu III

Organet Drejtuese e Këshilluese të UMSH

Neni 15

Senati Akademik

1. Senati akademik është organ kolegjal vendmimmarrës për çështje të drejtimit dhe të organizimit të veprimtarisë akademike në UMSH, i cili merr vendim për çështje brenda kompetencave të tij me shumicë të thjeshtë (50%+1) të votave të antarëve pjesëmarrës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë statut. Senati i zhvillon mbledhjet e tij nëse sigurohet numri i nevojshëm prej 2/3 e antarëve. Ai programon , bashkërendon , drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor dhe vlerëson efikasitetin e tyre. Senati Akademik mblidhet periodikisht, së paku 4 herë në vit dhe drejtohet nga Kryetari i Senatit i cili është Rektori.
2. Senati Akademik përbëhet nga së paku 9 anëtarë. Anëtarë të senatit Akademik janë: Rektori, Dekanët e Fakulteteve (jo më shumë se 1/3 e antarëve), anëtarë të zgjedhur (jo më pak se 2/3) e antarëve, janë përfaqësues të personelit mësimor shkencor të brendshëm dhe të jashtëm të zgjedhur nga departamentet, përfaqësues të Qendres Mesdheu me status akademik, një përfaqësues nga Keshilli studentor i institucionit/kryetari, i cili përfaqëson studentët në senat. Anëtarët e zgjedhur të Senatit Akademik kanë mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, ndërsa përfaqësuesi i studnetëve do të jetë kryetari i zgjedhur nga Këshilli studentor i Institucionit. Në rastet kur mandati i antarëve të zgjedhur ose antarëve përfaqësues të Qendrës Mesdheu me status akademik në senat, mbaron para afatit të përcaktuar për arsye të largimit nga detyra për çështje personale apo çështje të tjera lidhur me detyrën, vendi i tij zihet nga një anëtar tjetër i cili zgjidhet përkundrejt të njëjtave procedura dhe me kohëzgjatje sa pjesa e mbetur e mandatit të antarit të cilin ai zëvendëson dhe me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Mandati i antarit të Senatit mbaron me mbarimin e afatit 4 vjeçar për antarët e zgjedhur, me largimin nga detyra për antarët e emëruar për shkak të detyrës, me kërkesën e tyre, për shkelje të kodit etik të institucionit, në rastet kur ndaj tyre ka filluar një procedim penal, në rastet e largimit në një detyrë tjetër.

Funksionet e Senatit Akademik janë:

- a) Garanton respektimin e parimeve të autonomisë, lirisë akademike e të kërkimit si dhe të drejtat e studentëve.
- b) Miraton planin disavjeçar të zhvillimit të institucionit dhe programin vjetor të veprimtarive të tij;
- c) Miraton Projekt Buxhetin e UMSH, të përgatitur nga Rektorati dhe ia paraqet për miratim sipas kompetencave Qendrës Mesdheu.
- d) Përcakton politikën e drejtimit e zhvillimit e të perspektivës të universitetit në përputhje me parimet e Procesit të Bolonjës e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Arsimit
- e) Shqyrton e miraton projekt statutin e UMSH me dy të tretat e votave të antarëve të tij;
- f) Miraton rregulloret e institucionit, që janë kompetencë e tij dhe mbikqyr zbatimin e tyre

- g) Miraton programet e studimit, të kërkimit e zhvillimit apo pjesë të tyre, në kuadër të hapjes/përshtatjes apo riorganizimit të tyre, si dhe hapjen, ndryshimin ose mbylljen e njësisve mësimore ose kërkimore;
- h) Përzgjedh anëtarët e Këshillit të Etikës
- i) Miraton nëse do të ketë kritere pranimi në ciklet e studimeve dhe nëse do të ketë cilat do të jenë ato, mbështetur në këshillat e fakulteteve.

Neni 16 Rektorati

Rektorati është një organ ekzekutiv i cili kryesohet nga Rektori. Rektori përgjigjet për ndjekjen dhe/ ose ekzekutimin e të gjitha vendimeve të Senatit.

Funksionet kryesore të Rektoratit janë:

- a) Harton planin disavjecar të zhvillimit të institucionit.
- b) Harton programin vjetor të veprimtarive, si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit në Senatin Akademik.
- c) Paraqet rekomandime për projektet për programet e studimeve, të kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre.
- d) Zbaton të gjitha vendimet e miratuara nga Senati Akademik të cilat i drejtohen atij.
- e) Monitoron dhe publikon rezultatet e vlerësimit të veprimtarive të institucionit.
- f) Propozon strukturën e përgjithshme institucionale si dhe kategoritë e personelit akademik që nevojiten sipas niveleve të arsimit.
- g) Harton raportin vjetor të veprimtarive mësimore e kurrikulare dhe e paraqet atë në senat.

Organizimi dhe funksionimi i rektoratit dhe personelit të tij si dhe veprimtarive përcaktohet në rregulloren e institucionit.

Neni 17 Këshilli i administrimit

Këshilli i administrimit është organ kolegjal vendimmarrës, që mbikëqyr e kontrollojnë veprimtaritë e institucionit të arsimit të lartë, që lidhen me menaxhimin administrativ, financiar, ekonomik dhe të pronave të tij.

Kompetencat e këshillit të administrimit janë:

- a) miraton kriteret për ndarjen e burimeve financiare;
- b) miraton, me kërkesën e senatit akademik, projektbuxhetin e institucionit me dy të tretat e votave;
- c) miraton strukturën dhe numrin e personelit të institucionit për të gjitha nivelet;
- d) miraton raportin vjetor financiar të paraqitur nga rektorati;
- e) vlerëson nga pikëpamja ekonomike planin e zhvillimit të institucionit e programin vjetor të veprimtarive të tij;
- f) miraton rregulloren e brendshme për administrimin, financat dhe kontabilitetin;
- g) miraton rregulloren e funksionimit të tij.

Rektori dhe kancelari i Universitetit kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e këshillit të administrimit, pa të drejtë vote, kur e vlerësojnë ata vetë, si dhe kur thirren nga ky këshill.

Këshilli i administrimit përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë me mandate 4 (katër) vjeçarë, nga të cilët:

- a) 2(dy) anëtarë zgjidhen nga personeli akademik;
 - b) 3(tre) anëtarë caktohen nga Qendra Themeluese;
 - c) një anëtar është përfaqësues i zgjedhur nga këshilli i studentëve të Universitetit.
- Anëtarësia në këshillin e administrimit është e papajtuashme me detyrën e anëtarit të

senatit akademik dhe të dekanëve.

Këshilli i administrimit zgjedh kryetarin, prej anëtarëve të brendshëm të tij, me dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve.

Këshilli i administrimit mblidhet çdo 3 (tre) muaj.

Neni 18

Këshilli i Fakultetit

Këshilli i Fakultetit është organ kolegjal vendimmarrës, i cili merr vendim për çeshtje brenda kompetencave të tij me shumice të thjeshtë (50%+1) të votave të anëtarëve pjesëmarrës, me përjashtim të rasteve ku parashikohet ndryshe në këtë statut. KF i zhvillon mbledhjet e tij nëse sigurohet numri i nevojshëm prej 2/3 të anëtarëve .

KF përbëhet nga Dekani, përgjegjësit e departamenteve dhe përgjegjësi i qendrës së kërkimit dhe të zhvillimit dhe një përfaqësues i studentëve, kryetari i Keshillit studentor të Fakultetit. KF kryesohet nga dekani.

Funksionet e KF:

- a) Programon e përcakton, në bazë të propozimeve të departamenteve, përdorimin e burimeve njërezore dhe materiale në dispozicion të fakultetit.
- b) Bën propozime në Senat për programe të reja studimi ose të kërkimit shkencor, ose edhe për ndryshime në programet ekzistuese të studimit, mbështetur në propozimet e ardhura nga departamentet ose dhe me iniciativë e tij.
- c) I propozon senati hapjen, ndryshimin ose mbylljen e departamenteve ose njësisive të tjera
- d) Përgatit rregulloren mësimore për cdo program studimi të njësisë së tij, dhe ia dërgon për miratim senatit akademik
- e) Propozon senatit kriteret e vecanta për pranimin e studentëve në programet e studimit
- f) Jep mendim për rregulloren e institucionit , për çeshtje brenda fushave të tij të kompetencës
- g) Jep mendim për rregullore ose akte të tjera të institucionit, mbështetur në kërkesën e Rektorit
- h) Shqyrton dhe miraton raportin vjetor të dekanit për veprimtarinë mesimore dhe kërkimin shkencor
- i) I propozon senatit akademik planin strategjik të zhvillimit të fakultetit dhe mbikqyr realizimin e tij.

Neni 19

Bordi këshillimor

Bordi Këshillimor i Universitetit "Mesdhetar" të Shqipërisë është një organ kolegjal këshillimor i përbërë nga autoritete të shquara. Bordi Këshillimor thirret e drejtohet nga Rektori apo nga i deleguari i tij. Caktimi i anëtarëve të Bordit Këshillimor dhe i Kryetarit të tij bëhet nga Qendra Themeluese në bashkëpunim me autoritetet drejtuese të Universitetit "Mesdhetar" të Shqipërisë.

Bordi Këshillimor është organ konsultativ i përbërë nga 7 deri në 9 personalitete të fushave të ndryshme. Përbërja dhe numri i antarëve të bordit përcaktohet me vendim të Qendrës Mesdheu në konsultim me Rektorin

Funksionet e tij janë:

- a) të shqyrtojë dhe të vlerësojë veprimtarinë e përgjithshme të Universitetit;
- b) të shqyrtojë dhe bëjë propozime për planin e zhvillimit institucional;

- c) të shqyrtojë, të sugjerojë dhe të mbështesë zgjerimin e bashkëpunimit të Universitetit "Mesdhetar" të Shqipërisë me institucionet dhe subjektet e tjera në funksion të planit të zhvillimit institucional;
- d) të kontribuojë në sigurimin e donacioneve të ndryshme në funksion të planit të zhvillimit institucional. Bordi Këshillimor mblidhet të paktën dy herë në vit.

Neni 20 **Këshilli i Etikës**

Këshilli i Etikës është një organ kolegjal këshillimor pranë UMSH, i cili mblidhet sa herë ka çeshtje për të diskutuar, por jo më pak se 2 herë në vit dhe diskuton probleme të etikës së jetës universitare brenda tij. Këshilli i Etikës merr vendim me shumicë të thjeshtë (50%+1) dhe i bën propozimet përkatëse Rektorit.

Ai përbëhet nga 3 anëtarë:

- a) një anëtar i Qendrës Themelues
- b) dy specialistë të njohur të etikës

Anëtarët e KE përzgjidhen nga Senati akademik. Lidhur me çeshtje të etikës të cilat nuk parashikohen në këtë statut apo në rregulloren e UMSH, do të rregullohen nga Kodi i Etikës, i cili është një akt i vecantë i UMSH.

Neni 21 **Këshilli i Profesorëve**

Këshilli i Profesorëve i UMSH është organ kolegjal i cili ngrihet për organizimin dhe drejtimin e studimeve të doktoratës dhe të kualifikimit shkencor e pedagogjik pas doktoratës, në njësitë kryesore të Universitetit, të cilat ofrojnë programe studimi të ciklit të tretë. Ai përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë, të zgjedhur nga këshilli i fakultetit përkatës.

Neni 22 **Komiteti shkencor**

Komiteti shkencor është organ kolegjal i cili është përgjegjës për organizimin e studimeve për programet e ciklit të dytë. Ai përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë, i zgjedhur nga këshilli i fakultetit përkatës.

Autoritetet drejtuese

Neni 23 **Rektori**

Rektori është autoriteti drejtues i UMSH, dhe vepron në emër dhe për llogari të tij përkundrejt të drejtave të përcaktuara në këtë statut. Rektori është drejtuesi kryesor i institucionit dhe emërohet nga Qendra Themeluese, me pelqimin e Bordit të besimit dhe ka mandat XXX vjeçar me të drejtë rrizgjedhjeje. Marrëdhëniet me shoqërinë / qendrën përcaktohen në kontratën e punës.

Mandati i Rektorit mbaron kur: mandati i tij nuk rinovohet nga Qendra Themeluese, ai largohet në një detyrë tjetër, jep dorëheqjen, prish kontratën për arsye personale shëndetsore, shkarkohet nga Qendra Themeluese dhe nëse do të hapet ndonjë çeshtje

penale ndaj tij. Vendi i tij zihet nga një autoritet tjetër i kontraktuar në Institucion dhe mandati fillon nga fillimi. Deri në zgjedhjen e autoritetit të ri, Qendra mesdheu, e UMSH vendos zëvendësimin e tij nga Zv/rektori ose një tjetër person me kualifikime të ngjashme.

Rektori duhet të ketë të paktën titullin, Profesor i Asociuar.

Rektori ka këto kompetenca kryesore:

Kryeson Senatën Akademik

- a) Drejton dhe koordinon aktivitetin mësimor dhe shkencor të UMSH
- b) Ndjek dhe zbaton vendimet e senatit akademik dhe të administratorit të shoqërisë dhe nxjerr akte të nevojshme në vijim të tyre.
- c) Garanton lirinë akademike dhe kërkimore të stafit
- d) Nënshkruan diploma dhe certifikatat e tjera të UMSH
- e) Merr pjesë në hartimin dhe miratimin e rregullores dhe të akteve rregullatore të UMSH
- f) Miraton kandidaturat e personelit akademik të UMSH
- g) Propozon masa disiplinore në Këshillin e Etikës për anëtarët pjesëmarrës të rektoratit, si dhe për personelin administrativ të UMSH, që kanë kryer veprime në kundërshtim me statutin dhe me rregulloren e UMSH, kanë thyer Kodin Etik, apo nuk kanë repektuar detyrimet e përcaktuara në Kodin e Punës apo në kontratën e punës
- h) Merr vendime për propozimet e Këshillit të Etikës
- i) Vepron në emër të UMSH dhe e përfaqëson para publikut të gjerë në ceremoni e organizime si dhe në marrëdhënie me të tretët
- j) Përfaqëson UMSH në konferencën e Rektorëve
- k) Kryen cdo detyrë tjetër të përcaktuar në këtë statut

Neni 24

Dekani

Dekani është autoriteti drejtues i Fakultetit dhe përfaqësues i tij. Dekani emërohet nga Rektori, me mandat 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje. Marrëdhëniet me qendrën themeluese përcaktohen në kontratën e punës. Dekani duhet të ketë të paktën titullin, Profesor i Asociuar.

Mandati i Dekanit mbaron kur: mandati i tij nuk rinovohet nga Qendra Themeluese, ai largohet në një detyrë tjetër, jep dorëheqjen, prish kontratën për arsye personale shëndetsore, shkarkohet nga Qendra Themeluese dhe nëse do të hapet ndonjë ceshtje penale ndaj tij. Vendi i tij zihet nga një autoritet tjetër i kontraktuar në Institucion dhe mandati fillon nga fillimi. Deri në zgjedhjen e autoritetit të ri, Qendra mesdheu, e UMSH vendos zëvendësimin e tij nga Zv/dekani ose një tjetër person me kualifikime të ngjashme.

Dekani ka këto kompetenca kryesore:

- a) Organizon, drejton dhe koordinon punën mësimore dhe shkencore të Fakultetit
- b) Ngre dhe miraton komisionet për përzgjedhjen e studentëve të rinj që pranohen cdo vit akademik
- c) Është pjesë e komisionit për vlerësimin e kandidaturave të stafit akademik të UMSH
- d) Bën deklaratën e vlerësimit akademik të kandidaturës së përzgjedhur, si pjesë e stafit akademik, e cila është kusht për lidhjen e kontratës së punës mes pedagogut dhe UMSH.
- e) Kur e sheh të arsyeshme, bën vlerësimin e pedagogëve gjatë viti akademik dhe për këtë qëllim ndjek zhvillimin e një orë leksioni/seminar në auditor me njoftim paraprak së paku 2 (dy) javë përpara.
- f) Ngre komisionet ad hoc sipas parashikimeve të rregulloreve të UMSH
- g) Së bashku me Sekretarin e Përgjithshëm nënshkruan listën emërore të studentëve që fitojnë të drejtën e dhënies së provimit, të plortësuar nga

sekretaria mësimore që i vihet në dispozicion pedagogut para hyrjes në provim.

- h) Cakton persona për kryerjen e monitorimit të provimeve që zhvillohen në UMSH.
- i) Drejton komisionet e transferimit dhe të mobilitetit të studentëve, të ndërprerjes dhe të rifillimit të studimeve në UMSH sipas parashikimeve të rregullores të UMSH.
- j) Së bashku me rektorin, nënshkruan diplomat e studentëve të UMSH
- k) Propozon masat disiplinore për studentët në Këshillin e Etikës
- l) Propozon masa disiplinore në Këshillin e Etikës për anëtarë të personelit akademik dhe atij ndihmës që kanë kryer veprime në kundërshtim me statutin e rregulloren e UMSH, kanë thyer kodin etik, apo nuk kanë rrespektuar detyrimet e përcaktuara në kodin e punës ose në kontratën e punës.

Drejtori i Institutit të kërkimit

Drejtori është autoriteti drejtues i institutit të kërkimit dhe zhvillimit dhe e përfaqëson atë në të gjitha instancat Brenda dhe jashtë Universitetit.

Neni 25

Përgjegjësi i departamentit propozohet nga dekani dhe emërohet nga rektori. Përgjegjësi i departamentit është autoriteti më i lartë i departamentin (njësi bazë punës mësimore kërkimore). Ai duhet të ketë gradën Dr.

Përgjegjësi i departamentit ka këto kompetenca:

- a) Shqyrton planet mësimore dhe programet mësimore dhe propozon ndryshimet e nevojshme.
- b) Shqyrton dhe jep mendim për tekstet mësimore që do përdoren
- c) Ndjek realizimin e programit mësimor sipas planit të miratuar dhe mbikqyr cilësinë e mësimdhënies
- d) Miraton e siglon tezat e provimeve
- e) Merr pjesë në komisionet e përzgjedhjes së pedagogëve të rinj në departamentin që drejton
- f) Bën vlerësimin e pedagogëve të departamentit gjatë vitit akademik dhe për këtë qëllim ndjek një orë leksion/seminar në auditor me njoftim paraprak së paku 2 (dy) javë përpara.

Përgjegjësi i qendrës është autoriteti më i lartë për këtë njësi. Ai propozohet nga dekani dhe emërohet nga rektori. Përgjegjësi i qendrës duhet të ketë gradën Dr.

Kompetencat e përgjegjësit të qendrës janë:

- a) Përcakton programin dhe tematikën e punës shkencore në qendër.
- b) Kontrollon realizimin e programit në lidhje me studimet dhe trajnimet sipas tematikës përkatëse
- c) Bashkëpunon ngushtë me departamentin përkatës dhe strukturat e tjera të UMSH

Neni 26

Autoritete të tjera të UMSH janë:

Administratori i cili emërohet nga Rektori. Ai ka këto kompetenca:

- a) Është përgjegjës për ceshtje të administrimit dhe organizimit të procesit akademik të mësimdhënies në UMSH
- b) Ndjek përmbushjen e detyrimeve të pedagogëve të UMSH dhe dorëzon listën përkatëse në zyrën e financës, pa të cilën kjo e fundit nuk procedon me kryerjen e pagesës.
- c) Mbikqyr procesin e transferimit, të mobilitetit, të ndërprerjes dhe të rifillimit të studimeve në UMSH sipas parashikimeve të rregullores të UMSH
- d) Nënshkruan së bashku me dekanin, listën emërore të studentëve që fitojnë të drejtën e dhënies së provimit, të plotësuar nga sekretaria mësimore që i vihet në dispozicion pedagogut para hyrjes në provim.
- e) Ai është përgjegjës për drejtimin e përditshëm, administrativ e financiar të UMSH,
- f) Për zbatimin e buxhetit, për mbikqyrjen dhe kontrollin e veprimeve financiare, si dhe për zbatimin e ligjshmërisë. Ai nënshkruan dhe lidh kontratat me studentët, ndjek arkëtimin e tarifave të studentëve, shlyerjen e detyrimeve të UMSH ndaj organeve shtetërore, për pagimin e taksave, të tatimeve , dhe të detyrimeve ndaj të treteve. Ai duhet të këtë një formim universitar ekonomik ose juridik.

Zëvendës Rektori/Zv. Dekani emërohet nga rektori/dekani, pas miratimit të kandidaturës të propozuar prej tij në senatin akademik. Zëvendës rektori/Zv. Dekani përfaqëson rektorin/dekanin në rast të mungesës së tij dhe kryen detyrat e ngarkuara prej tij.

Kreu IV

Organizimi i Studimeve

Neni 27

Forma e studimeve në UMSH është me kohë të plotë, ato janë të organizuara në module ose lëndë të vecanta, të shprehura në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe sipas standardeve të zonës europiane të studimeve. Module ose lëndë të vecanta në të cilat numri i studentëve është i vogël (nuk arrihet një grup), lënda/ moduli do të zhvillohet me program individual/ të vecantë, në grupe të vogla me titullarin e lëndës/ apo edhe lektorin nën kujdesin e titullarit të lëndës, ku ky i fundit e përcakton vetë ngarkesën përkatëse dhe shpërndarjen e lëndës. Rregulla specifike për këtë formë frekuentimi të lëndës/ modulit do të përcaktohen hollësisht në rregulloren mësimore të programit të

studimit.

Plani mësimor për çdo program studimi, konsultohet në mënyrë të herëpashërëshme me përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve ose të profesioneve respektive, dhe ai mund të ndryshojë për t'iu përshtatur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës.

Ngarkesa normale vjetore për çdo program studimi është mesatarisht 60 kredite. Studenti ka të drejtë të marrë më shumë kredite se kjo ngarkesë, duke respektuar prerekuizitat (detyrimet kushtëzuese). Këto kredite i zbriten nga ngarkesa e viteve pasardhëse.

Çdo program studimi rregullohet me rregullore mësimore të vecantë

UMSH ofron programe studimi të licensuara të ciklit të parë, ai parashikon të ofrojë programe të ciklit të dytë dhe më pas edhe programe të ciklit të tretë, përkundrejt plotësimit të kriterëve të përcaktuara nga legjislacioni në mënyrë progresive graduale e zhvillimit institucional Programet e studimeve në UMSH organizohen në tre cikle të njëpasnjëshme:

1. cikli i parë (Bachelor);
2. cikli i dytë (Master);
3. cikli i tretë (Doktoratë).

Neni 28

Ciklet e studimeve universitare në UMSH

1. Programet e Studimeve të ciklit të parë:

Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë të japin njohuri bazë mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në një shumëllojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh. Programet e studimeve të ciklit të parë në UMSH realizohen në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë, lëshohet diplomë "Bachelor" në fushën e arsimit të kryer.

Kanë të drejtë të kandidojnë për praninë në studimet e ciklit të parë në UMSH, kandidatët si më poshtë:

- shtetasit shqiptarë dhe të huaj që kanë përfunduar me sukses maturën shtetërore;
- studentët shqiptarë dhe të huaj që kanë një diplomë të shkollës së mesme apo të një vendi të huaj, ky i fundit ekuivalente me maturën shtetërore apo me shkollën e mesme

2. Programet e studimeve të ciklit të dytë:

2.1. Programet e studimeve "Master i shkencave"

Programet e studimeve të ciklit të dytë i pajisin studentët me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor në një fushë, brenda një specialiteti. Programet e studimeve të ciklit të dytë (Msc) realizohen në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të dytë lëshohet diplomë universitare "Master i shkencave" në fushën e arsimimit të kryer.

2.2. Programet e studimeve "Master profesional":

Programet e studimeve "Master profesional" u ofrojnë studentëve, arsimim dhe trajnim të mirëfilltë profesional;

Programet e studimeve "Master profesional" realizohen në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në përfundim të këtyre programeve të studimeve lëshohet diplomë universitare "Master profesional" në fushën e arsimit të trajnimit profesional të kryer;

Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve individë që zotërojnë një diplomë universitare së paku "Bachelor", ose individë që zotërojnë diplomë të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të, si dhe plotësojnë standardet specifike akademike të kriterëve të pranimit në ciklin e dytë të studimeve

Institucionet e arsimit të lartë kanë të drejtë të pranojnë kandidatë që kanë fituar diplomë "Master profesional" apo diploma të vlerësuara ekuivalente me të, në studimet e ciklit të dytë për diplomën universitare "Master i shkencave" dhe të vendosin kritere për njohjen/transferimin e krediteve të vlefshme të fituara në studimet e masterit që i përgjigjen programit të studimeve të ciklit të dytë.

Rregulla më specifike në lidhje me hartimin e programeve, kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve, veçoritë akademike, kohëzgjatjen dhe kreditet si dhe diplomat e programeve të studimeve të ciklit të dytë përcaktohen në rregulloret e fakulteteve.

3. Programet e studimeve të ciklit të tretë:

Programet e studimeve të doktoratës:

Programet e studimeve të doktoratës janë programe të studimeve të ciklit të tretë, me karakter plotësisht akademik, që kanë në bazë kërkim shkencor dhe veprimtari krijuese;

Këto programe të studimeve realizohen në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në përfundim të programeve të studimeve të doktoratës lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor" (Dr).

Në studimet e doktoratës kanë të drejtë të aplikojnë kandidatë që kanë fituar diplomë universitare "Master i shkencave"; ose një diplomë të integruar të nivelit të dytë ose një diplomë sipas sistemit të vjetër të pandarë në cikle studimi; Kriteret e tjera specifike përcaktohen në përputhje me aktet ligjore në fuqi në Rregulloren e studimeve të ciklit të tretë.

4. Studimet jouniversitare të natyrës profesionale

UMSH mund të ofrojë edhe programe të studimeve jouniversitare, të natyrës profesionale. Zgjatja normale e këtyre programeve është jo më pak se 2 vite akademike dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë jouniversitare.

Neni 29

Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies

Studimet në UMSH zhvillohen me bazë vitin akademik i cili organizohet në semestra me së paku 20 orë mësimi leksione, seminare e laboratorë në javë.

Neni 30

Kohëzgjatja e studimeve

Kohëzgjatja normale e studimeve në UMSH është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kohëzgjatja normale dhe ajo maksimale përcaktohet në rregulloren e programit të studimit.

Neni 31 Transferimet

UMSH ofron mundësi për transferime të studentëve në vite të ndërmjetme midis programeve të të njëjtit cikël, brenda vetë institucionit apo institucioneve të tjera të arsimit të lartë.

Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve, i takon njësisë kryesore që pranon studentin, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren e tij. Vendimin për kërkesën për transferim e merr Rektori.

Neni 32 Diplomimi

Studenti i cili ka shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit si dhe detyrimet financiare me UMSH, ka të drejtën e marrjes së diplomës. Të gjitha diplomat e ciklit të parë dhe të dytë të lëshuara nga UMSH shoqërohen me Supplementin e Diplomës i cili përmban informacione që parashikohen në aktet nënligjore përkatëse.

Diploma plotësohet, nënshkruhet nga Rektori, Dekani i Fakultetit, (kryetari për mbrojtjen e diplomave) dhe vulosen me vulën e UMSH. Diploma lëshohet vetëm 1 (një) herë.

Modeli i diplomës për çdo cikël studimi, në përputhje dhe me aktet nënligjore, do të regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatën për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, në MASH. Forma, elementët e sigurisë apo elementë të tjerë të diplomës, miratohen me vendim senati.

Dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni. Studentët që përfundojnë studimet me të gjitha dhjeta (10) pajisen dhe me certifikatë "Medalje e artë", ndërsa studentët që përfundojnë studimet me mbi 80% të notave 10 (dhjeta) dhe pjesën tjetër vetëm 9 (nënta) pajisen edhe me certifikatë "Student i shkëlqyer"

Kreu VI

Detyrat e të Drejtat e Studentëve

Neni 33

Studenti e fiton cilësinë si i tillë me regjistrimin në UMSH dhe me marrjen e numrit të matrikullimit dhe e humbet këtë status me marrjen e diplomës nga ana e tij ose me përjashtimin e tij nga Universiteti. Studentët janë të detyruar të zbatojnë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga planet mësimore, ato që lindin nga ky Statut, Rregullorja e Universitetit për kryerjen e studimeve në këtë Universitet. Ata duhet të jenë në dijeni të të gjitha detyrimeve e të jenë të vetëdijshëm për zbatimin e tyre. Universiteti "Mesdhetar" i Shqipërisë nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre. Marrja e masave të ndryshme ndëshkimore deri në përjashtim nga Universiteti, për rastet e moszbatimit të detyrimeve dhe të shkeljes së normave të akteve të mësipërme, kryhet nga Rektori pasi të jetë marrë mendimi i Senatit. Kriteret dhe procedurat përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.

Studentët kanë të drejtë:

- a) Të përdorin të gjithë infrastrukturën mësimore shkencore të Universitetit për veprimtarinë mësimore shkencore, sipas programeve e rregulloreve përkatëse;
- b) të përdorin biblioteken;
- c) të përfaqësohen në Senat;
- d) të përfitojnë burse studimi, kur plotësojnë kushtet e përcaktuara nga Qendra Themeluese;
- e) të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet e parashikuar për studentët, në përputhje me Ligjin Nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe në këtë statut.
- f) Të shprehin opinionet e tyre në lidhje me cilësinë e mësimdhënies dhe të personelit akademik të UMSH
- g) Të transferojë studimet/kreditet nga një program studimi në një program tjetër brenda UMSH
- h) Të transferojë studimet/kreditet nga institucione të tjera të arsimit të lartë në UMSH dhe anasjelltas.

Studentët kanë detyrë:

- a) të zbatojnë Statutin dhe rregulloret në fuqi të institucionit
- b) t'u kushtojnë vëmendjen e duhur studimeve dhe të marrin pjesë në veprimtaritë akademike;
- c) të paguajnë tarifat e shkollimeve dhe të shërbimeve që u ofrojnë institucionet;
- d) të respektojnë kodin e etikës
- e) të tregojnë vëmendjen e duhur ndaj të drejtave të personelit dhe të studentëve të tjerë.

Neni 34

Këshilli i studentëve

1. Këshilli i studentëve është organizim i pavarur i studentëve të UMSH, I cili nuk zhvillon veprimtari politike dhe ekonomike. Ky këshill koordinon përfaqësimin e tyre në organet drjetuese të UMSH, sic përcaktohet në këtë statut.
2. Veprimtaria e Këshillit Studentor bazohet në Ligjin Nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", në këtë statut si dhe në aktet për organizimin dhe funksionimin e vetë këshillit.
3. Këshilli i Studentëve në UMSH, shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të UMSH, për planet dhe programet e

studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, propozimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilanci vjetorë paraprakë të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive.etj

4. Këshilli i Studentëve të UMSH harton statutin dhe rregulloren për funksionimin e tij. Miratimi i akteve të mësipërme është kompetencë e Rektorit të UMSH.

Kreu VII

Punesimi në UMSH

Neni 35

Personeli i Universitetit "Mesdhetar" të Shqipërisë, sipas profilit të punës, grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- a) Personeli akademik
- b) Personeli ndihmës mësimor -shkencor;
- c) Personeli administrativ;

Neni 36

Përsonei akademik dhe drejtuesit akademik kryejnë veprimtari të mësimdhënies, kërkim shkencor ose të aplikuar, shërbime për zhvillimin e UMSH, këshillim për studentët, tutoriat dhe detyra administrative.

Personeli akademik ndahet në personel akademik efektiv (i punësuar me kohë të plotë) dhe personel akademik me kontratë (i punësuar me kohë të pjesshme).

Personeli akademik efektiv përbëhet nga drejtuesit dhe stafi akademik i brendshëm. Personeli akademik me kontratë përbëhet nga staf akademik i jashtëm dhe lektorë të ftuar.

Personeli akademik përzgjidhet me konkurs pas shqyrtimit nga një komision i vecantë, ku marrin pjesë Rektori, Dekani dhe/ose përgjegjësi i departamentit dhe një përfaqësues i Qendrës.

Kontrata e punës me personelin akademik, lidhet mbështetur në Ligjin Nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në republikën e shqipërisë", i ndryshuar dhe në Kodin e Punës.

Në kontratën e lidhur me UMSH përcaktohen saktë të drejta dhe detyrimet e personelit akademik, ngarkesa dhe format e saj

Neni 37

Përsonei ndihmës mësimor- shkencor kryen veprimtari ndihmëse në mësimdhënie, shërbime për zhvillimin e UMSH, këshillim për studentët dhe detyra administrative.

Personeli ndihmës mësimor- shkencor ndahet në personel i punësuar me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme.

Personeli ndihmës mësimor- shkencor përzgjidhet me konkurs pas shqyrtimit nga një komision i vecantë, ku marrin pjesë Rektori, Dekani dhe/ose përgjegjësi i departamentit dhe një përfaqësues i Qendrës.

Neni 38

Përsonei administrativ kryen veprimtari administrative në ndihmë të procesit mësimor dhe atij kërkimor në UMSH sipas detyrave të përcaktuara. Ai ndihmon në realizimin e misionit të institucionit.

Personeli administrativ përzgjidhet me konkurs pas shqyrtimit nga një komision i vecantë, ku marrin pjesë përfaqësues të Rektoratit, Administratori (apo persona të deleguar prej tyre), një përfaqësues i Qendrës si dhe personi nën varësinë e të cilit do të punojë aplikanti i zgjedhur.

Kontratat e punës, për personelin e Universitetit, nënshkruhen nga:

- a) Qendra Themeluese për Rektoren, për Administratorin, Sekretarinë, Përgjegjësin e Zyrës Juridike;
- b) Dekanët
- c) Në rast se këto funksione kryhen nga anëtarë të Qendrës Themeluese, duhet të nënshkruhen marrëveshje ad hoc.

Kushtet e kontratës së punës, koha për të cilën lidhet ajo dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me marrëdhëniet juridike të punës, mbështeten edhe në legjislacionin në fuqi.

Neni 39

Norma mësimore dhe koha e punës

Norma e mësimdhënies për të gjithë personelin e Universitetit miratohen nga Qendra Themeluese mbi bazuar në aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi.

Neni 40

Pagesa

Struktura e pagave për të gjitha kategoritë e personelit, me kohë të plotë ose të pjesshme, miratohet nga Qendra Themeluese mbi bazën e propozimit të Sekretarit të përgjithshëm pas konsultimit me Rektorin dhe Zyrën Juridike. Pagesa për mbi normën dhe orët e punës jashtë orarit, referuar detyrës funksionale, për të gjitha kategoritë e personelit, kryhet mbështetur në legjislacionin në fuqi dhe pasqyrohet në kontratën e punës.

Për shërbimet jashtë shtetit dhe brenda shtetit, të personelit shqiptar ose të huaj, të angazhuar në veprimtari mësimore, shkencore, teknike e administrative për llogari të Universitetit "Mesdhetar" të Shqipërisë, Qendra Themeluese miraton kuotën e pagesave, mbi bazën e propozimit të Rektorit.

Për kryerjen e veprimtarive të veçanta jashtë detyrës funksionale, mbi bazë angazhimi kontraktual, për të gjitha kategoritë e personelit, kryhet një pagesë suplementare.

Neni 41

Masat disiplinore

Llojet e masave disiplinore janë:

- Tërheqje vemëndje
- Vërejtje me shkrim
- Vërejtje me paralajmërim
- Pezullim nga detyra
- Largim nga puna

Masat disiplinore jepen nga autoritetet drejtuese të institucionit.

Kreu VIII

Vula zyrtare dhe stema

Neni 42

Vula zyrtare e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë:

Në qendër dhe përreth shkruhet “UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË -
MEDITERRANEAN UNIVERSITY OF ALBANIA”.

Stema në formë rrethore që ka në përmbajtje: një anije me vela të periudhës mesjetare, mbështetur mbi një libër të hapur të një sfondi ngjyrë qielli ku janë të vendosur rrethazi disa yje të verdhë është simboli i Universitetit privat “Mesdhetar” të Shqipërisë.

Kreu IX

Dispozita kalimtare

Neni 43

Programet e studimit të fushave të ngjashme mund të mbulohen nga një njësi kryesore në rastin kur nuk arrihet numri minimal i studentëve të regjistruar (minimalisht 50 studentë për çdo program studimi).

Neni 44

Në përputhje me Ligjin Nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në përputhje me këtë statut përditësohet rregullorja e UMSH dhe të gjitha aktet e tjera në zbatim të këtij statuti.

Neni 45

Ky Statut i përmirësuar, është miratuar nga Senati Akademik i UMSH me datë 11.02.2013.